

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 28.09.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë
1. Problemi 1	20
2. Problemi 2	20
3. Problemi 3	20
4. Problemi 4	20
5. Problemi 5	20
Totali	100

Problemi 1. Annapolis sh.a, një kompani e listuar në bursë me 1 janar 2018 bleu 180,000 aksione të ekuitetit të Bismarck sh.a-së e cila është gjithashtu e listuar në bursë, në para për një shumë prej €377,950, kur fitimet e mbajtura të Bismarck sh.a-së ishin €38,400. Në po të njejtën datë, Annapolis sh.a bleu 30,000 aksione të ekuitetit të Concord sh.a-së për €82,000 kur fitimet e mbajtura të Concord ishin €124,950. Annapolis sh.a ushtron ndikim domëthënës mbi të gjitha aspektet operacionale të Concord sh.a-së si dhe mbi vendimet tjera.

Pasqyrat e pozitës financiare të Annapolis dhe kompanive në të cilat ka investuar, Bismarck dhe Concord me 31 dhjetor 2018 janë dhënë më poshtë:

	Annapolis	Bismarck	Concord
	€	€	€
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Prona, Fabrika dhe Paisjet	251,950	287,950	206,350
Investimet:			
180,000 aksione të zakonshme në Bismarck sipas kostos	377,950		
30,000 aksione të zakonshme në Concord sh.a	82,000		
Kredi tek Bismarck sh.a	<u>63,000</u>		
<i>Total pasuritë jo-qarkulluese</i>	774,900	287,950	206,350
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	50,800	72,050	51,300
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	157,000	66,000	59,700
Banka	<u>6,300</u>	<u>18,000</u>	<u>17,900</u>
<i>Total pasuritë qarkulluese</i>	<u>214,100</u>	<u>156,050</u>	<u>128,900</u>
Total pasuritë	989,000	444,000	335,250
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>			
Aksionet e ekuitetit prej €1 secila	630,000	240,000	120,000
Fitimet e mbajtura	<u>132,500</u>	<u>78,000</u>	<u>144,000</u>
Fondet e aksionarëve	762,500	318,000	264,000
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Huamarrjet afatgjata	163,500	63,000	59,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>			
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	<u>63,000</u>	<u>63,000</u>	<u>12,250</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	989,000	444,000	335,250

Informatat shitesë

- (i) Vlera e drejtë e ponës, fabrikës dhe paisjeve të Bismarck sh.a-së me 1 janar 2018 tejkaloi vlerën bartëse për €6,500. Ky tejkalim i është atribuar një ndërtesë në pronësi të Bismarck sh.a, e cila në datën e blerjes kishte jetë të mbetur të përdorimit prej 20 viteve. Annapolis sh.a zhvlerëson ndërtesat në baza drejtvizore.
- (ii) Annapolis sh.a i dha Bismarck sh.a-së një kredi 10 vjeçare prej €63,000 me 1 janar 2018. Me 31 dhjetor 2018, €270 të interesit të kredisë kishte arritur për pagesë por nuk ishte

paguar. Edhe Annapolis sh.a edhe Bismarck sh.a kanë përlogaritur interesin në fund të vitit.

- (iii) Annapolis sh.a kohë pas kohë bën tregti me Bismarck sh.a. Në dhjetor 2018, Annapolis sh.a shiti mallra tek Bismarck sh.a për €24,000. Annapolis sh.a përdor një marzhë mbi kosto prej 25% në të gjitha shitjet e saj. Me 31 dhjetor 2018, të gjitha këto mallra ishin përfshirë në stoqet përfundimtare të Bismarck sh.a.
- (iv) Para se të ndodhte shitja e muajit dhjetor për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018, Annapolis sh.a ka tregtuar me Bismarck sh.a edhe më herët dhe u krijuan saldo të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve prej €50,000 të arkëtueshme nga Bismarck sh.a dhe €36,000 të pagueshme tek Annapolis sh.a. Këto shuma janë përfshirë në të pagueshmet dhe të arkëtueshmet respektive në saldot më sipër. Diferenca prej €14,000 është përshkak se Bismarck sh.a leshoi një çek prej €14,000 me 29 dhjetor 2018 tek Annapolis sh.a i cili nuk kishte arritur deri me 7 janar 2018.
- (v) Annapolis sh.a vlerëson IJK duke përdorur metoden e vlerës së drejtë dhe vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes ishte €7,000.
- (vi) Zëri i mirë në Bismarck sh.a është dëmtuar për 10% dhe investimi në Concord sh.a është dëmtuar për €1,250.

Kërkohe:

Përgadite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare të Grupit Annapolis me 31 dhjetor 2018. (25 pikë)

1.**Grupi Annapolis****Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018**

€

Pasuritë jo-qarkulluese

Prona, Fabrika dhe Paisjet (251,950 + 287,950 + 6,175) 546,075

Zëri i mirë (LL2) 90,045

Investimet në Concord (LL4) 85,513*Total pasuritë jo-qarkulluese* 721,633*Pasuritë qarkulluese*

Stoqet (50,800 + 72,050 - 4,800) 118,050

Të arkëtueshmet tregtare (157,000 + 66,000 - 14,000 - 36,000 - 270) 172,730

Banka (6,300 + 18,000 + 14,000) 38,300*Total pasuritë qarkulluese* 329,080**Total pasuritë** **1,050,713***Ekuiteti dhe detyrimet*

Kapitali aksionar 630,000

Fitimet e mbajtura (LL5) 153,165

Interesi jo-kontrollues (LL6) 14,318

797,483

Detyrimet afatgjata

Huamarrjet afatgjata 163,500

*Detyrimet afatshkurtëra*Të pagueshmet tregtare dhe të tjera (63,000 + 63,000 - 36,000 - 270) 89,730**Total ekuiteti dhe detyrimet** **1,050,713**

Llogaritjet

1. Annapolis

Data e blerjes 1 janar 18 30,000/120,000 = 25%

Data e blerjes 1 janar 18 180,000/240,000 = 75%

Andaj, Bismarck sh.a është një filial/degë i/e Annapolis sh.a ndërsa Concord sh.a është një shoqëri e Annapolis sh.a.

2. Zëri i mirë

Konsiderata e blerjes: € €

Paraja 377,950

Vlera e drejtë e IJK-së 7,000

384,950

Minus vlera e drejtë e pasurive neto të blera:

Kapitali aksionar 240,000

Fitimet e mbajtura para blerjes 38,400

Korigjim i vlerës së drejtë (L13) 6,500 (284,900)

Zëri i mirë bruto 100,050

Humbja nga dëmtimi (10,005)**Neto Zëri i mirë** **90,045**

3. Korigjimi i vlerës së drejtë

	Në blerje	Lëvizja	Në raportim
	€	€	€
Ndërtesat	6,500	325	6,175
Zhvlerësimi vjetor: $6,500/20$ vite = 325.			

4. Vlera bartëse e investimit në Concord sh.a me 31 dhjetor 2018

	€
Kosto e investimit	82,000
Plus pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura të Concord sh.a pas blerjes (LL5)	4,763
Minus humbjet nga dëmtimi	<u>(1,250)</u>
Vlera bartëse e investimit	85,513

5. Fitimet e mbajtura të konsoliduara

	Annapolis	Bismarck	Concord
	€	€	€
Sipas pyetjes	132,500	78,000	144,000
Minus F.M pas blerjes		(38,400)	<u>(124,950)</u>
Minus zhvlerësimi shtesë		<u>(325)</u>	19,050
Minus FPR	(4,800)	39,275	
Pjesa e grupit në Bismarck: (75% x 39,275)	29,456		
Pjesa e grupit në Concord: (25% x 19,050)	4,763		
Pjesa e grupit e humbjeve nga dëmtimi: (75% x 10,005)	(7,504)		
Dëmtimi në investime	<u>(1,250)</u>		
Fitimet e mbajtura të grupit	153,165		

6. Interesi jo-kontrollues

	€
Vlera e drejtë e IJK-së në blerje	7,000
Pjesa e fitimeve pas blerjes që i takon IJK-së (25% x 39,275)	9,819
Pjesa e humbjeve nga dëmtimi që i takon IJK-së (25% x 10,005)	<u>(2,501)</u>
IJK në raportim	14,318

7. Fitimi i porealizuar

Shitjet $24,000 \times 25/125 = 4,800$.

Problemi 2.

(i)

Me 1 janar 2018, Topeka sh.a kishte në pronësi një ndërtesë të cilën e kishte blere para 5 viteve për €800,000. Ndërtesa në kohën kur ishte blerë kishte një jetë të vlerësuar të përdorimit prej 20 viteve. Me 1 janar 2018 kishte vlerë bartëse prej €525,000. Kjo shumë bartëse është pas një rishikimi për dëmtim të shkaktuar me 31 dhjetor 2017 prej €75,000. Me 31 dhjetor 2018, një vlerësues profesionist i angazhuar nga Bordi i Drejtorëve të Topeka sh.a këshilloi që ndërtesa kishte një vlerë të drejtë prej €750,000 andaj kompania e rivlerësoi në shumën e njejtë. **(7 pikë)**

(ii)

Topeka sh.a ka plane për tu zgjeruar me qëllim të shfrytëzimit të perspektivës së biznesit. Kompania aplikoi për një grant të qeverisë me qëllim të blerjes së një fabrike për prodhim dhe për një grant për punësimin e 300 punëtorve të rinj. Me 1 korrik 2018, 20% e kostos së fabrikës e cila kushtoi €200,000 është pranuar si grant për të financuar blerjen e fabrikës e cila filloi operimin në po atë ditë. Fabrika zhvlerësohet 15% sipas metodës së saldës së zbritur.

Granti për punësimin e 300 punëtorve të rinj është i kushtëzuar në faktin që punëtorët do të mbesin të punësuar gjatë tre viteve të ardhshme. Supozo që kjo ka shumë gjasa. Buxheti i punësimit të Topeka sh.a është draftuar dhe tregon së do të punësoj 100 punëtor deri në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018; 150 në vitin vijues dhe në fund 50 punëtorë në vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020.

Granti në lidhje me rekrutimin e punëtorve prej €300,000 është pranuar me 1 janar 2018. Është politikë e Topeka sh.a-së që të kontabilizoj grantin e lidhur me të hyrat dhe pasuritë duke përdorur metodën e të ardhurave të shtyera. **(8 pikë)**

Kërkohet:

Shpjego trajtimin në kontabilitet për transaksionin (i) dhe (ii) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018, në pajtim kërkesat e SNK 16 Prona, Fabrika dhe Paisjet dhe SNK 20 Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Shpalosjet e Asistencës nga Qeveria. **(Total: 15 pikë)**

2.

i)

Ekstrakt nga Pasqyra e të Ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

Anulimi i rënies në vlerë (dëmtimi)	75,000
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Teprica e rivlerësimit (260-75)	185,000

Ekstrakt nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018

Pasuritë jo-qarkulluese	
Prona, fabrika dhe paisjet	750,000

Shpjegim i trajtimit në kontabilitet

Ndërtesa e Topeka sh.a është vlerësuar me 31 dhjetor 2018, duke rritur vlerën për €260,000. Kjo është bërë pas një rivlerësimi që ka zvogëluar vlerën për €75,000 me 1 janar 2018. Sipas SNK 16 Prona, Fabrika dhe Paisjet, një rritje në vlerë që bëhet pas rënies në vlerë duhet së pari të anulohet rënien në vlerë e më pas të kreditohet tek rezervat. Kjo hyrje e dyfishtë do të jetë si në vijim:

D Pasuritë jo-qarkulluese	260,000
K fitimi dhe humbja (anulim)	75,000
K Teprica e rivlerësimit	185,000

ii)

Ekstrakt nga Pasqyra e të Ardhurave për vitin e përfunduar:

me 31 dhjetor 2018

Të hyrat nga granti (100 + 3)	103,000
Shpenzimet e zhvlerësimit	(15,000)

Shifrat për 2 vitet e ardhshme do të jenë si në vijim (nuk është kërkuar në detyrë):

31 dhjetor 2019

Të hyrat nga granti (150 + 5.55)	155,550
Zhpenzimet e zhvlerësimit	(27,750)

31 dhjetor 2020

Të hyrat nga granti (50 + 4.718)	54,718
Zhpenzimet e zhvlerësimit	(23,588)

Ekstraktet e pasqyrës së pozitës financiare me:

31 dhjetor 2018

PPF ((85% x 200)/2)	185,000
D.A.GJ të hyrat e shtyera (40,000- 8,550) + 50,000	81,450
D.A.SH të hyrat e shtyera (150,000 + 5,550)	155,550

Shifrat për 2 vitet e ardhshme do të jenë si në vijim (nuk është kërkuar në detyrë):

31 dhjetor 2019

PFP (85% x 185,000)	157,250
D.A.GJ të hyrat e shtyera (40,000- 13,268)	26,732
D.A.SH të hyrat e shtyera (4,718 + 50,000)	54,718

31 dhjetor 2020

PFP (85% x 157,250)	133,662
D.A.GJ të hyrat e shtyera (40,000 - 17,277)	22,722
D.A.SH të hyrat e shtyera	4,010

Shpjegimi i trajtimit në kontabilitet

Pasuritë e lidhura me grantin të cilat përdorin metodën e të hyrave të shtyera kërkojnë që granti të llogaritet duke përdorur metodën e zhvlerësimit, në këtë rast 15% sipas saldës së zbritur. Granti në vitin e parë duhet të shpërndahet proporcionalisht duke u bazuar në muajin në të cilin granti është marrë dhe pasuria është shfrytëzuar. Pasi që kjo ishte me 1 korrik 2018, shumën e grantit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 është €3,000 [$15\% \times 20\% \times 200,000$] x 6/12. Saldo e grantit në fund të vitit do të jete €37,000 e ndarë në detyrimet afatgjata dhe afatshkurtëra.

Për grantin e lidhur me të hyrat, duhet të alokohet në baza sistematike duke u bazuar në numrin e të punësuarve çdo vit. Për shembull 100/300 punonjës x €300,000 duhet të njihet në vitin e parë përderisa pjesa tjetër shtyhet.

Llogaritja (i)

Kostoja fillestare me 1 janar 2018	800,000
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2018 (800,000/20 vite x 5 vite)	<u>(200,000)</u>
Vlera bartëse me 1 janar 2018	600,000
Humbja nga dëmtimi	<u>(75,000)</u>
Vlera e dëmtuar me 1 janar 2018	525,000
Shpenzimet e zhvlerësimit deri me 31 dhjetor 2018 [525,000/15 vite]	<u>(35,000)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2018	490,000
Teprica e rivlerësimit	<u>260,000</u>
Shuma e rivlerësuar	750,000

Llogaritja (ii)

Granti i lidhur me pasuri

Shuma e grantit $20\% \times 200,000 = 40,000$

Alokimi i grantit:

Vitit i përfunduar me 31 dhjetor 2018 - $15\% \times 40,000 = 6,000 \times 6/12 = 3,000$

Vitit i përfunduar me 31 dhjetor 2019 - $15\% \times 37,000 = 5,550$

Vitit i përfunduar me 31 dhjetor 2020 - $15\% \times 31,450 = 4,718$

Granti i lidhur me të hyrat

Vitit i përfunduar me 31 dhjetor 2018: $100/300 \times \text{€}300,000 = \text{€}100,000$

Vitit i përfunduar me 31 dhjetor 2019: $150/300 \times \text{€}300,000 = \text{€}150,000$

Vitit i përfunduar me 31 dhjetor 2020: $50/300 \times \text{€}300,000 = \text{€}50,000$

Vitet 2019 dhe 2020 nuk janë kërkuar në detyrë. Janë vetëm për shpjegim.

Problemi 3. Madison sh.a është një kompani e cila i furnizon mishtoret me mish. Më poshtë janë rezultatet e saj për dy vite.

Madison sh.a

Pasqyra e të Ardhurave dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

	2018	2017
	€'000	€'000
Shitjet	24,000	18,000
Kosto e shitjeve	<u>16,800</u>	<u>12,000</u>
Fitimi bruto	7,200	6,000
Kostot e shpërndarjes	1,200	1,000
Kostot administrative	800	750
Kostot financiare	<u>620</u>	<u>840</u>
Fitimi para tatimit	4,580	3,410
Tatimi	<u>573</u>	<u>426</u>
Fitimi për vitin	4,007	2,984
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	<u>0</u>	<u>0</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	4,007	2,984

Madison sh.a

Pasqyra e Pozitës Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

	2018	2018	2017	2017
	€'000	€'000	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		13,200		11,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Stoqet	1,400		1,800	
Të arkëtueshmet tregtare	2,000		1,200	
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>1,200</u>		<u>400</u>	
<i>Total pasuritë qarkulluese</i>		<u>4,600</u>		<u>3,400</u>
Total Pasuritë		17,800		14,400
<i>Ekuiteti & detyrimet</i>				
<i>Ekuiteti</i>				
Kapitali aksionar i zakonshëm (€1)		2,000		2,000
Fitimet e mbajtura		<u>4,767</u>		<u>760</u>
Total Ekuiteti		6,767		2,760
<i>Detyrimet afatgjata</i>				
Borxhi afatgjatë		9,000		10,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>				
Të pagueshmet tregtare		1,400		1,200
Mbitërheqja bankare		240		60
Tatimi		120		180
Akrualet		<u>273</u>		<u>200</u>
<i>Total detyrimet afatshkurtëra</i>		<u>2,033</u>		<u>1,640</u>
Total ekuiteti dhe detyrime		17,800		14,400

Shënim:

- (i) Stokset në fillim të vitit 2017 ishin €2,000,000.
- (ii) Numri i aksioneve të zakonshme të emetuara ishte 2,000,000 në të dy vitet.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
(iii) Çmimi aktual për aksion të zakonshëm	€26.00	€15.00

Kërkohe:

- (a) Llogariti koeficientët në vijim për të dy vitet për Madison sh.a.
 - (1) Përqindja e fitimit bruto
 - (2) Përqindja e fitimit neto
 - (3) Koeficienti i shpejtë
 - (4) Ditët e të arkëtueshmeve tregtare
 - (5) Ditët e të pagueshmeve tregtare
 - (6) Mbulimi i interesit
 - (7) Fitmi për aksion
 - (8) Koeficienti çmin/fitim (8 pikë)

- (b) Drafto një raport për Bordin e Drejtorëve të Madison sh.a në të cilin ju e komentoni pozitën dhe performancën financiare të kompanisë. Përdori koeficientët e llogaritur në (a) më sipër si bazë për komentet tuaja. (10 pikë)
(Formati dhe prezantimi: 2 pikë)
(Total: 20 pikë)

3.

	2018	2017
Përqindja e fitimit bruto	$7,200/24,000 = 30.00\%$	$6,000/18,000 = 33.33\%$
Përqindja e fitimit neto	$4,007/24,000 = 16.70\%$	$2,984/18,000 = 16.58\%$
Koeficienti i shpejtë	$(4,600 - 1,400)/2,033 = 1.57:1$	$(3,400 - 1,800)/1,640 = 0.98:1$
Ditët e të arkëtueshmeve tregtare	$2,000/24,000*365 = 30$ ditë	$1,200/18,000*365 = 24$ ditë
Ditët e të pagueshmeve tregtare	$1,400/16,800*365 = 30$ ditë	$1,200/12,000*365 = 37$ ditë
ose	$1,400/16,400*365 = 31$ ditë	$1,200/11,800*365 = 37$ ditë
Mbulimi i interesit	$5,200/620 = 8.39$ here	$4,250/840 = 5.06$ here
Fitmi për aksion	$4,007/2,000 = €2.00$	$2,984/2,000 = €1.49$
Koeficienti çmim/fitim	$€26.00/€2.00 = 13.00$	$€15.00/€1.49 = 10.07$

Përqindja e fitimit bruto

Përqindja e fitimit bruto është zvogëluar nga 33.33% në 30.00%, një zvogëlim prej 9.99% në përqindje nga viti në vit që është një trend negativ për kompaninë. Të hyrat janë rritur për 33.33% nga vitit në vit, por për fat të keq kostot e shitjes janë rritur për 40% nga viti në vit. Nëse i shikojmë blerjet, këto janë rritur nga €11.8 milion në €16.4 milion që paraqet një rritje prej 38.98%. Kjo rritje është më e lartë se sa rritja në të hyrat, dhe nga këndvështrimi i kompanisë, duket se ajo ka pasur rritje në çmimet e blerjeve të cilat kompania nuk ka qenë në gjendje t'i kaloj tek klientët e saj dhe kjo është diçka që menaxhmenti duhet ta adresoj në vitin 2019.

	2018	2017	% rritja
Stoqet në fillim	1,800	2,000	- 10.00%
+ Blerjet (saldo balancuese)	16,400	11,800	+ 38.98%
- Stoqet në fund	<u>(1,400)</u>	<u>(1,800)</u>	- 22.22%
= Kosto e shitjeve	16,800	12,000	

Përqindja e fitimit neto

% e fitimit neto është rritur nga 16.58% në 16.70% e cila paraqet një rritje prej pak mbi 0.72% nga viti në vit në përqindje. Kjo është një performancë e mirë duke pasur parasysh rënien në marzhën bruto. Arsyeja kryesore për ndryshimin nga marzha bruto në marzhen neto është ndryshimi në koston financiare nga vitit në vit. Kompania ka zvogëluar shumën e borxhit afatgjatë për 10% nga viti në vit por ka arritur një zvogëlim në kosto financiare prej 26.19% e cila sugjeron që është rifinancuar borxhi më një normë më të mirë të interesit (veçanërisht dukë marrë parasysh rritjen e mbitërheqjes bankare në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017). Kompania gjithashtu ka mbajtur kontroll të arsyeshëm në kostot administrative të cilat janë rritur për 6.67% nga viti në vit. Kostot e shpërndarjes janë rritur për 20% nga viti në vit por përsëri ky ishte një rezultat i mirë duke pasur parasysh rritjen në shitje.

Koeficienti i shpejtë

Ky koeficient është rritur nga 0.98:1 në 1.57:1 këtë vit që paraqet një përmirësim prej mbi 60% nga viti në vit. Arsyeja kryesore është fakti që pasuritë qarkulluese minus stoqet u rriten për 100% kryesisht për shkak të rritjes së parasë e cila u rrit për 200% dhe të arkëtueshmet tregtare që u rriten për €800,000 apo mbi 66% nga viti në vit. Detyrimet afatshkurtëra u rriten për më pak se

24% të shkaktuara kryesisht nga rritja e mbitërheqjes bankare prej €180,000. Ky ishte një rezultat i mirë në përgjithësi pasi që kompania ka rritur të hyrat ndjeshëm gjë që mund të vendos kufizime në kapitalin punues. Por pëkundër, koeficienti i shpejtë është rritur këtë vit dhe kompania gjithashtu ka blerë disa pasuri jo-qarkulluese ekstra dhe ka paguar një pjesë të borxhit afatgjatë (zvogëluar për 10%). Një pjesë e zvogëlimit të këtij borxhi mund të jetë financuar nga mbitërheqja bankare andaj Madison sh.a duhet të sigurohet që burimi i financimit është i përshtatshëm nga këndvështrimi i kohës. Madison sh.a duhet të zvogëloj paranë dhe ekuivalentët e parasë në pasuritë qarkulluese me qëllim të zvogëlimit të mbitërheqjes bankare dhe të kursej edhe më shumë kosto financiare.

Ditët e të arkëtueshmeve tregtare

Janë rritur nga 24 ditë në 30 ditë, një rritje prej 25% nga viti në vit që është një përkeqësim edhe pse ditët e të arkëtueshmeve tregtare prej 30 ditë paraqet ende një rezultat të mirë në përgjithësi. Të hyrat janë rritur mbi 33.33% por Madison sh.a është dashur të siguroj që të mos ketë përkeqësim në ditët e të arkëtueshmeve tregtare. Kompani është dashur të siguroj që rritja në të hyra nuk është shkaktuar nga klientët të cilët kërkojnë afat më të gjatë të pagesës. Kompania duhet të vazhdoj të fokusohet në menaxhimin e të arkëtueshmeve tregtare në vitin e ardhshëm.

Ditët e të pagueshmeve tregtare

Kjo është zvogëluar nga 37 ditë në 30 ditë që është një përkeqësim prej afër 19% nga vitit në vit. Rritja në blerje ndoshta ka ndikuar që disa prej furnitorëve të kompanisë kanë vendosur kufizime në shumën e stoqeve që do ta shësin para së të paguhen dhe si pasojë, kjo ka nënkuptuar që ditët e të pagueshmeve tregtare janë zvogëluar. Nëse e krahasojmë me vitin 2017, diferenca ndërmjet kohës kur paraja është pranuar nga të arkëtueshmet tregtare dhe të kohës kur është paguar për të pagueshmet tregtare është zvogëluar nga 13 ditë në 0 ditë gjë që ka vendosur pak presion në rrjedhat e parasë të kompanisë dhe ka kontribuar në rritjen e mbitërheqjes bankare.

Mbulimi i interesit

Mbulimi i interesit është rritur si rezultat i zvogëlimit të kostos financiare por edhe rritjes së FPIT. Interesi mbulohet me shumë se 8 herë nga FPIT dhe paraqet një nivel të ulët të rrezikut financiar.

Fitmi për aksion

Është rritur nga 149 cent për aksion në 200 cent për aksion, e cila është një rritje prej mbi 34%. Ky është një trend pozitiv dhe është i nxitur nga rritja në fitime të cilat kompania i ka arritur në vitin 2018. Kompani do të jetë në gjendje të përdor këtë fitim për të stimuluar rritjen aktuale dhe të ardhshme.

Koeficienti çmim/fitim

Ky koeficient është rritur nga 10.07 në 13.00, një rritje prej mbi 29% nga viti në vit. Kjo rritje është kryesisht për shkak të rritjes së çmimit të aksionit i cili është rritur për 73.33% nga viti në vit. Siç pamë në seksionin e mëhershëm, fitimi për aksion është rritur me një përqindje të lartë këtë vit por çmimi për aksion është rritur ndjeshëm gjatë vitit.

Një koeficient Ç/F prej 13 është i mjaftueshëm dhe sigurisht investitorët janë duke e parë këtë kompani si mundësi për të blerë aksione dhe arsyeja kryesore është rritja e shitjeve dhe fitimit neto dhe menaxhim i mirë i parasë së gatshme dhe i kredive nga vitit 2017 në vitin 2018.

Problemi 4. Tallahassee sh.a is është një kompani e listuar në bursë e cila merret me prodhim. Pasqyrat e saj të përmbledhura financiare janë paraqitur më poshtë:

Pasqyra e Pozitës Financiare për Tallahassee sh.a me:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	€' 000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	45,000	45,150
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	5,250	4,500
Të arkëtueshmet tregtare	3,150	2,700
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>930</u>	<u>450</u>
<i>Total pasuritë qarkulluese</i>	<u>9,330</u>	<u>7,650</u>
Total pasuritë	54,330	52,800
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
€0.50 aksione të zakonshme	18,000	9,000
Premia e aksioneve	16,500	12,000
Fitimet e mbajtura	<u>5,103</u>	<u>3,000</u>
<i>Total fondet e aksionarëve</i>	39,603	24,000
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Notë krediti	7,200	21,000
Tatimi i shtyrë	<u>1,620</u>	<u>1,350</u>
<i>Total detyrimet afatgjata</i>	8,820	22,350
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	3,000	4,200
Tatimi i pagueshëm	2,727	2,250
Provizionet	<u>180</u>	<u>-</u>
<i>Total detyrimet afatshkurtëra</i>	<u>5,907</u>	<u>6,450</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	54,330	52,800

Pasqyra e të Ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

	€'000
Të hyrat	48,000
Kosto e shitjeve	<u>(30,000)</u>
Fitimi bruto	18,000
Shpenzimet administrative	(6,000)
Kosto e shpërndarjes	<u>(3,600)</u>
Fitimi operativ	8,400
Kosto financiare	<u>(1,800)</u>
Fitimi para tatimit	6,600
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(2,997)</u>
Fitimi për vitin	3,603

Informatat në vijim duhet të merren parasysh:

- (i) Me 31 mars 2018, Tallahassee sh.a emetoi 4,000,000 aksione bonus, të cilat u pasuan me emetim të të drejtave, duke përdorur preminë e aksioneve për emetimin bonus.
- (ii) Gjatë vitit, Tallahassee sh.a shiti një fabrike për €180,000. Në datën e shitjes, kishte vlerë bartëse prej €105,000. Fitimi nga kjo shitje është përfshirë në fitimin operativ për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.
- (iii) Të pagueshmet tregtare kanë përfshirë interes të pagueshëm prej €990,000 dhe €1,800,000 me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 respektivisht.
- (iv) Tallahassee sh.a ripagoi një pjesë të notës së saj të kreditit në shumë prej €13,800,000 me 30 shtator 2018.
- (v) Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin ishin €3,330,000. Kjo është përfshirë në koston e shitjes.
- (vi) Tallahassee sh.a është këshilluar nga avokatët e saj se është e mundur që do të humbasë rastin në gjyq dhe ka ndarë provizion prej €180,000 për koston e vlerësuar për këtë rast. Kjo është e përfshirë në shpenzimet administrative.

Kërkohet:

- (a) **Përgadite Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë të Tallahassee sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 në pajtim me SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë duke përdorur metoden indirekte. (17 pikë)**
- (b) **Shpjego rëndësinë e informative të rrjedhës së parasë krahasuar me informatata e fitimeve. (3 pikë)**

4.

a) Pasqyra e rrjedhjes së parasë për Tallahassee sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.

	€'000
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative</i>	
Fitimi para tatimit	6,600
Provizionet	180
Shpenzimet e zhvlerësimit	3,330
Shpenzimet e interesit	1,800
Minus fitimi nga shitja (II1)	<u>(75)</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	11,835
Korigjimet për levizjet në kapitalin qarkullues:	
Rritja në stoqe (5,250 - 4,500)	(750)
Rritja në të arkëtueshmet (3,150 - 2,700)	(450)
Zvogëlimi në të pagueshmet (2,400 - 2,010)	<u>(390)</u>
Para e gjeneruar nga operacionet	10,245
Interesi i paguar (II3)	(2,610)
Tatimi i paguar (II4)	<u>(2,250)</u>
Net rrjedha e parasë e gjeneruar nga aktivitetet operative	5,385
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese</i>	
Paraja e paguar për blerje të PFP (II5)	(3,285)
Arkëtimet nga shitja e PFP	<u>180</u>
Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese	(3,105)
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese</i>	
Arkëtimi nga emetimi i aksioneve (II6)	13,500
Nota e kreditit e ripaguar	(13,800)
Dividenda e paguar (II7)	<u>(1,500)</u>
Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese	(1,800)
Neto rritja ne paranë dhe ekuivalentët e parasë	480
Shto paranë dhe ekuivalentët e parasë me 1 janar 2018	<u>450</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor 2018	930

b) Rëndësia e pasqyrës së rrjedhjes së parasë krahasuar me pasqyrën e të ardhurave:

- Ju mundëson shfrytëzuesve të vlerësojnë borxhin dhe solvencën
- Ndhmon në identifikimin e problemeve më heret
- Rrjedhat e parasë janë një mënyrë më objektive për të vlerësuar performancën krahasuar me fitimin
- Ndhmon të verehet se nga është duke u gjeneruara paraja, nga aktivitetet kryesore apo ato jo-kryesore.
- I ndihmon shfrytëzuesit të vlerësojnë aftësinë e adaptimit financiar, p.sh sa është në gjendje entiteti t'i ndryshoj rrjedhat e parasë si kudërpërgjigje ndaj ngjarjeve të papritura.
- Është gjithashtu më lehtë të auditohen informatat e rrjedhës së parasë se sa ato të fitimit.

Llogaritjet (të gjitha shumat janë në €'000) përveç nëse thuhet ndryshe.

1. Fitimi nga shitja e fabrikës

Arkëtimet nga shitja	180
Vlera bartëse	<u>(105)</u>
Fitimi nga shitja	75

2. Të pagueshmet tregtare

	2018	2017
Të pagueshmet sipas PPF	3,000	4,200
Minus interesi i pagueshem	<u>(990)</u>	<u>(1,800)</u>
Të pagueshmet tregtare	2,010	2,400

3. Interesi i paguar

Interesi akrual s/fillim	1,800
Plus kosto gjatë vitit	1,800
Minus s/fund	<u>(990)</u>
Interesi i paguar	2,610

4. Tatimi i paguar

Tatimi i shtyrë s/fillim	1,350
Tatimi aktual s/fillim	2,250
Shto shpenzimet e vitit	2,997
Tatimi i shtyrë s/fund	<u>(1,620)</u>
Tatimi aktual s/fund	<u>(2,727)</u>
Tatimi i paguar	2,250

5. Paraja e paguar për blerje të PFP

PFP vlera bartëse s/fillim	45,000
Plus VB e fabrikës së shitur	105
Plus zhvlerësimi	3,330
Minus VB e PFP s/fund	<u>(45,150)</u>
Paraja e paguar për blerje të PFP	3,285

6. Arkëtimi nga emetimi i aksioneve

	2018	2017
Kapitali aksionar	18,000	9,000
Premia e aksioneve	<u>16,500</u>	<u>12,000</u>
	34,500	21,000

Total diferenca 13,500 (34,500 - 21,000). Vlera e e emtimit bonus = €0.50 x 4,000,000 aksione = €2,000. Një rritje prej €2,000 në kapitalin aksionar dhe zvogëlim në preminë e aksioneve duhet të zbritet/shtohen nga diferenca prej €13,500. Kjo na le arkëtime neto prej €13,500.

7. Dividenda e paguar

Fitimet e mbajtura s/fillim	3,000
Plus fitimi i vitit	3,603
Minus fitimet e mbajtura s/fund	<u>(5,103)</u>
Dividenda e paguar	1,500

Problemi 5.

a) Draft fitimi pas tatimit i Hartford sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 është €10.2 milion. Në fillim të vitit financiar, kompania kishte 3.6 milion aksione të zakonshme prej €1. Me 1 prill 2018, Hartford sh.a emetoi 48,000 aksione të zakonshme prej €1 për një shumë prej €600,000.

Kërkohet:

Llogarite fitimin bazik për aksion për Hartford sh.a për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2018 (rrumbullakëso në cent) në pajtim me SNK 33 *Fitimet për Aksion*. (5 pikë)

b) Grupi Olympia ka në pronësi një numër të pronave në regjionin verior. Tri prej këtyre pronave janë të leshuara me qira vjetore, detajet e të cilave janë si në vijim:

Prona	Jetëgjatësia	Kosto	Vlera me 31 dhjetor 2017	Vlera me 31 dhjetor 2018
		€'000	€'000	€'000
1	50 vite	200	275	225
2	40 vite	180	240	210
3	15 vite	150	175	180

Që të tri pronat janë blerë me 1 janar 2017, dhe vlerësimi i tyre është i bazuar në moshën e tyre në datën e vlerësimit. Prona 1 i është dhënë me qira një filiale (60% në pronësi) të Olympia me kushte normale komerciale, përderisa Prona 2 dhe Prona 3 i janë dhënë me qira në kushte normale komerciale kompanive që nuk janë të ndërlidhura me Olympia sh.a. Olympia sh.a ka adoptuar modelin e vlerës së drejtë të kontabilizimit të pronave investuese në pajtim me SNK 40 *Pronat Investuese* dhe modelin e koston historike për trajtimin e pronave të zëna nga pronari sipas SNK 16 *Prona, Fabrika dhe Paisjet*. Zhvlerësimi vjetor, aty ku kërkohet bazohet në vlerën bartëse të pronës në fillim të periudhës së kontabilitetit dhe është në baza drejtvizore.

Kërkohet:

Përgaditi ekstraktet e Pasqyrës së Konsoliduar të të Ardhurave të grupit Olympia për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 dhe Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare në po atë datë sa i përket pronave të mësipërme. (5 pikë)

c) SNK 12 *Tatimet* jep udhëzime për trajtimin e mbi apo nën provizionimit të tatimeve nga entitetet raportuese. Gjatë vitit të përfunduar në mars 2019, Frankfort sh.a finalizoi dhe pagoi detyrimin e saj për tatimin në korporata për fitimet e vitit të përfunduar me 31 mars 2018, për një shumë prej €21 milion. Më heret kishte vlerësuar një provizion për tatimin në fitim të korporatave prej €25 milion në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2018. Drejtorët kanë vlerësuar detyrimin për vitin e përfunduar me 31 mars 2019 në shumë prej €24.5 milion.

Kërkohet:

Shpjego trajtimin e transaksionit të mësipërm në pasqyrat financiare të Frankfort sh.a për vitin e përfunduar me 31 mars 2019 sa i përket tatimeve. (5 pikë)

d) Helena sh.a është duke i përgaditur pasqyrat finansiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. Helena sh.a hyri në një marrëveshje kontraktuale me 1 shtator 2018 me një kompani tjetër, Salem sh.a, për të themeluar një kompani të palistuar në bursë Harrisburg Electronics. Megjithatë në këtë aranzhim Helena sh.a ka vetëm 15% pronësi të aksioneve dhe nuk ka ndikim domethënës në politikat ditore finansiare dhe operacionale. Helena sh.a ka regjistruar investimin në Harrisburg Electronics sipas koston me 1 shtator 2018, e cila është vlera bartëse e paisjes dhe parasë së transferuar në atë datë. Nuk janë bërë ndryshime më pas në vlerën bartëse.

Kërkohe:

Këshillo drejtorët për trajtimin në kontabilitet të investimit të mësipërm në pasqyrat finansiare të Helena sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (5 pikë)

5.

a) Numri mesatar i ponderuar i aksioneve:

1 janar 2018 s/fillim	3,600,000
1 prill -31 dhjetor (48,000 x 9/12 = 36,000)	<u>36,000</u>
	3,636,000

Fitimi bazik për aksion = €10,200,000 / 3,636,000 = €2.81.

b) Prona 1 i është dhënë me qira një entiteti tjetër të grupit. Nga perspektiva e grupit, kjo pronë nuk është pronë investuese siç definohet nga SNK 40, andaj duhet të kontabilizohet sipas SNK 16. Pronat 2 dhe 3 janë prona investuese dhe kontabilizohet sipas modelit të vlerës së drejtë të matjes siç kërkohet nga SNK 40.

Grupi Olympia

Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018 (Ekstrakt)

Pasuritë jo-qarkulluese	Kosto/vlerësimi €'000	Zhvl i akm. €'000	VNL €'000
PPE (Property 1)	200 [2 vite]	(8)	192
Prona Investuese 2	210	-	210
Prona Investuese 3	180	-	180

Grupi Olympia

Pasqyra e Konsoliduar e të Arshurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 (Ekstrakt)

	€'000
Zhvlerësimi [Prona 1]	(4)
Rënis në vlerën e drejtë të pronës investuese 2 [240 - 210]	(30)
Rritja në vlerën e drejtë të pronës investuese 3 [175 - 180]	5

c)

- Shuma prej €4 milion është mbivlerësuar në vitin e kaluar.
- Andaj provizioni për vitin aktual duhet të zvogëlohet për atë shumë. Pra një detyrim i pritur prej €24.5 milion kërkon një provizion prej €20.5 milion.
- Detyrimi është ende €24.5 milion pasi që kjo shumë pritet të paguhet.
- Provizioni leviz nga shifra aktuale prej €4 milion kredi në nivelin e kërkuar prej €24.5 milion kredi.

d)

- Investimi në Harrisburg Electronics është një pasuri financiare pasi që është investim në aksione. Investimet e tilla duhet fillimisht të regjistrohen sipas vlerës së drejtë sipas SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*.
- Si pasojë, vlera e drejtë është vlera e drejtë e paisjeve plus paraja e transferuar.